Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 96-të të mbajtur më 27.11.2023, ka miratuar sa vijon,

## VENDIM

Denoncimi I regjistruar me numër 12-3839/1 nga 04.08.2023, **СЕ ЗАПИРА.**

Denoncimi i dorëzuar të dorëzohet në Ministrinë e Punëve të Brendshme të RMV-së për veprime kompetente.

Lënda me numër 12-3839 të 2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Lënda me numër 12-3839/1 datë 04.08.2023 është ngritur në bazë të denoncimit të dorëzuar nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për pasuri të fituar në mënyrë disproporcionale të personit ///, i cili si kryetar i partisë politike /// ka grumbulluar para për ndikime të kundërligjshme gjatë punësimit të personave në organet dhe institucionet shtetërore. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Nuk u paraqit asnjë provë në mbështetje të kërkesës.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së raportit, KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk ka elemente për veprim kompetent. Autoriteti kompetent që mund të shqyrtojë pretendimet nga denoncimi është Ministria e Punëve të Brendshme e RMV-së, për të cilën denoncimi i dorëzuar do t'i përcillet këtij autoriteti për veprim kompetent.

Për sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dërguar:

- parashtruesi i denoncimit

përgatiti: Mr. D.D .
miratoi: G.T anëtar i KSHPK-së.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
**Kryetar,**
**Biljana Ivanovska**

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut
email: contact@dksk.org.mk
тел/tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.mk

ДКСК KSHPK
ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut
email: contact@dksk.org.mk
тел/tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.mk